



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 88 prot.

Kamëz, më 14.06.2024

V E N D I M

Nr. 88 .Datë 14/06 2024

MBI

“NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 113, DATË 21.12.2001 TË KËSHILLIT  
BASHKIAK”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 14.06.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.48 Datë 10.06.2024 Në mbështetje të nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative; Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”; Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 18.12.2023 “Mbi miratimin e detajimit të buxhetit për vitet 2024, 2025, 2026”; Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 113, datë 21.12.2001 “Mbi krijimin e Ndërmarrjes së Pastrim-Gjelbërimit dhe Treg, brenda territorit të Bashkisë Kamëz”, si vijon:
  - Ishte: “Ndërmarrja e Pastrim-Gjelbërimit dhe Tregjeve, brenda territorit të Bashkisë Kamëz”;
  - Bëhet: “Ndërmarrja e Pastrimit, Kamëz”.
2. Numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Pastrimit, Kamëz do të jetë 125 (njëqind e njëzet e pesë).
3. Efektet financiare të këtij vendimi do të miratohen nga Buxheti i Bashkisë Kamëz sipas zërit buxhetor Gr.0, Kap.5, Prog.06260.
4. Për krijimin e strukturës së Ndërmarrjes së Pastrimit, Kamëz ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kamëz.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, Drejtoria e Burimeve Njerëzore si dhe Ndërmarrja e Pastrimi-Gjelbërimit dhe Tregjeve.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

